



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. 4974 Prot

Shkodër, më 19.03.2020

- PROJEKT - VENDIM

Nr. 86 Datë 19.03.2020

**“PËR DISA NDRYSHIME NË VKB NR.1, DATË 22.01.2016 "PËR TAKSAT DHE
TARIFAT VENDORE NË BASHKINË SHKODËR”, TË NDRYSHUAR**

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës _____. _____. 2020, me propozim të kryetares të bashkisë, mbështetur në nenin 9 pika 1.3 shkronja “a”, nenit 35, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore”, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, të ligjit Nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile", sipas relacionit bashkëlidhë,

VENDOSI :

1. Miratimin e ndryshimeve, në VKB nr.1, datë 22.01.2016 “Për taksat dhe tarifat vendore në Bashkinë Shkodër”, të ndryshuar:

A: Të përjashtohen nga taksa e pronës dhe tarifat vendore (pastrim, gjelbrim, ndriçim publik) për një periudhë 3-mujore viti 2020, për të gjitha kategoritë e taksapaguesve:

- a) individë, familje;
- b) persona fizik dhe juridik, ambulant;
- c) OJF, Institucione publike;

në territorin e Bashkisë Shkodër: (Lagje 1, Lagje 2, Lagje 3, Lagje 4, Lagje 5, Njësitë Administrative Velipojë, Bërdicë, Ana e Malit, Dajç, Guri i Zi, Postrinë, Rrethina, Pult, Shalë, Shosh)

B: Të përjashtohen nga kamatvonesat e detyrimeve vendore dhe gjobave për të gjitha kategoritë e taksapaguesve:

- d) individë, familje;
- e) persona fizik dhe juridik, ambulancë;
- f) OJF, Institucione publike;

në territorin e Bashkisë Shkodër: (Lagje 1, Lagje 2, Lagje 3, Lagje 4, Lagje 5, Njësitë Administrative Velipojë, Bërdicë, Ana e Malit, Dajç, Guri i Zi, Postribë, Rrethina, Pult, Shalë, Shosh).

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes

KRYETAR
Voltana Ademi

